



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 20200310/5

Tiranë ___/___/2021

Lënda: *Rekomandohet respektimi i procedurës për miratimin ose refuzimin e kërkesës së të dënuarit për të përfituar leje shpërblyese (rasti i të dënuarit V. M.)*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

Drejtorit të Përgjithshëm
Z. Agim Ismaili
Tiranë

I nderuar Z. Ismaili,

I dënuari V. M. na është drejtuar me një letër në muajin Shkurt 2019, ku pretendonte se nuk kishte marrë përgjigje lidhur me kërkesën për të përfituar leje shpërblyese, kërkesë që ishte bërë në vitin 2018, kur ai vuante dënimin në IEVP Fushë-Krujë, në seksionin e sigurisë së lartë.

Për verifikimin e kësaj ankese nga ana jonë është kërkuar të na vihet në dispozicion dokumentacioni që ka të bëjë me kërkesën e të dënuarit V. M. për të përfituar leje shpërblyese si dhe është analizuar legjislacioni i kohës¹ që përcaktonte rregullat dhe procedurat që duhet të respektohen për këto raste. Për hetimin e rastit kemi pasur një

¹ Tërësia e akteve ligjore e nënligjore që kanë qenë në fuqi në atë kohë, të cilat kanë rregulluar të drejtën e të dënuarve për të përfituar leje shpërblyese dhe procedurat përkatëse janë si vijon:

- Neni 59 i Ligjit Nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i shfuqizuar aktualisht nga Ligji Nr.81/2020;
- Nenet 50, 51 dhe 52 të VKM Nr.437, datë 20.05.2020 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë Nr.103, datë 14.02.2014 “Për rregullimin e disa çështjeve që kanë të bëjnë me procedurën e dhënies së lejeve shpërblyese apo të veçanta personave të dënuar me burgim”;
- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit protokolluar respektivisht nga secili institucion me Nr.2157/1 Prot., datë 17.03.2015 dhe Nr.1054/1 Prot., datë 16.03.2015.

komunikim shkresor në vijimësi me Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fushë-Krujë, Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Fillimisht po përshkruajmë procedurën e parashikuar ligjore që duhet të ndiqet nga institucionet kur një i dënuar i sigurisë së lartë paraqet një kërkesë për të përfituar leje shpërblyese.

Lejet shpërblyese për të dënuarit që ndodhen në regjimin e sigurisë së lartë jepen vetëm me urdhër të Ministrit të Drejtësisë ose me autorizimin e tij nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve. Ministri i Drejtësisë apo Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, me marrjen e kërkesës për leje nga i dënuari, i kërkojnë drejtorit të IEVP-së të përgatisë informacionin përkatës, që ka të bëjë me vlerësimin e kushteve ligjore nga sektori i sigurisë, sektori i çështjeve shoqërore, sektori ligjor dhe komisariati i policisë që mbulon territorin ku do të shkojë me leje i dënuari. Brenda 7 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për leje shpërblyese, kjo kërkesë duhet të miratohet ose refuzohet (Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit gjatë hetimit administrativ edhe për raste të mëparshme, afati kohor prej 7 ditësh i parashikuar në ligj është konsideruar efektivisht i shkurtër dhe i pamjaftueshëm pasi nuk është marrë parasysh kohëzgjatja e nevojshme që duhet për të përcjellë dokumentacionin si dhe kohëzgjatja që i duhet komisarit të policisë për të mbledhur informacion në terren). Sipas parashikimit ligjor, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale llogarit pjesën e mbetur të dënimit dhe vlerëson sjelljen e të dënuarit në përputhje me kriteret si vijon: respektimi i rregullave të disiplinës, motivimi për të marrë pjesë në programe rehabilituese si dhe rrezikshmëria shoqërore. Kriteri i fundit, për sa i përket besueshmërisë së të dënuarit gjatë qëndrimit me leje jashtë IEVP-së, vlerësohet nga Policia e Shtetit në bazë të një marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Në rast të refuzimit të kërkesës për leje shpërblyese, i dënuari mund të ankohet brenda 5 ditëve në gjykatë, e cila vendos për kërkesën për leje.

Referuar dokumentacionit që na është vënë në dispozicion rezulton si vijon:

IEVP Fushë-Krujë i është drejtuar me shkresën Nr. 2478/1 Prot., datë 19.04.2018 Komisarit të Policisë Nr.4, që mbulon vendbanimin e të dënuarit V. M., ku i kërkon informacion mbi problemet, konfliktet si dhe çdo informacion tjetër të vlefshëm nëse ky i dënuar përbën rrezik për rendin dhe sigurinë nëse trajtohet me leje shpërblyese.

Komisariati i Policisë Nr.4 i ka kthyer përgjigje IEVP Fushë-Krujë me shkresën Nr.2437/1 Prot., datë 03.05.2018, nëpërmjet së cilës i bën me dije se: *“Nga informacionet e deri tanishme të marra në mënyrë konfidenciale dhe nga takime dhe informacione të marra nga kryeplaku i kësaj zone (Rruga “_____”) nuk rezulton të ketë ndonjë informacion për të dënuarin V. M., që nuk mund të kthehet tek vendi i vuajtjes së dënimit, për ndonjë konflikt të mundshëm të familjes ose të mbartura në komunitet më parë, kallëzim ose procedim penal”*.

Në datën 17.05.2018 është regjistruar në Ministrinë e Drejtësisë kërkesa e të dënuarit V. M. për t'u trajtuar me leje shpërblyese, pasi i ka plotësuar afatet dhe kriteret ligjore.

Me shkresën Nr.1993/7 Prot., datë 19.06.2018, Ministria e Drejtësisë autorizon Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve² për vlerësimin e kërkesës së këtij të dënuari.

Në zbatim të këtij autorizimi, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i dërgon për kompetencë I EVP Fushë-Krujë trajtimin e kësaj kërkesë me shkresën Nr.721/5-M Prot., datë 26.06.2018.

I dënuari V. M. duke mos marrë një përgjigje lidhur me adresimin e kërkesës së tij për t'u trajtuar me leje shpërblyese, i drejtohet me dy letra Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve³, konkretisht në datat 19.09.2018 dhe 10.10.2018, ku ankohet se dërgimi i tij me leje shpërblyese ka mbetur pezull për shkak të ndërrimit të drejtorit të përgjithshëm dhe kërkon të trajtohet rasti i tij sipas autorizimit të Ministrit të Drejtësisë. Ndër të tjera, i dënuari përmend edhe një takim ndërmjet drejtorit të mëparshëm (z. Çuko) dhe babait të tij, ku i është premtuar se do të dalë me leje.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i dërgon sërish për kompetencë I EVP Fushë-Krujë, kërkesën e të dënuarit, me shkresën Nr.721/7-M Prot., datë 12.10.2018.

Nga ana e saj, I EVP Fushë-Krujë i dërgon një informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me shkresën Nr.2244 Prot., datë 30.10.2018, ku vë në dijeni se i dënuari V. M., me siguri të lartë, ka hyrë në afatet ligjore për të përfutur leje shpërblyese, se është kërkuar informacion nga Komisariati i Policisë Nr.4 dhe citohet përgjigja që ka dhënë ky komisarjat. Gjithashtu, I EVP Fushë-Krujë shprehet se, referuar vlerësimit të sjelljes 6 mujore të përpiluar nga stafi i kujdesit social, rezulton se sjellja dhe qëndrimi i të dënuarit vlerësohet pozitivisht dhe konform kërkesave të rregullores, ai nuk ka marrë masë disiplinore, është përfshirë në organikën e të burgosurve të punësuar dhe se me familjarët e të afërmit mban kontakte të rregullta.

Më tej komunikimi institucional, ka vijuar me email-in e datës 21.11.2018, me anën e të cilit Përgjegjësi i Sektorit Ligjor në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve i drejtohet I EVP Fushë-Krujë, ku kërkon:

- *Së pari*, vlerësim nga sektorët përkatës lidhur me sjelljen, rrezikshmërinë dhe besueshmërinë për trajtimin ose jo me leje, nisur nga rrezikshmëria e veprës penale
- *Së dyti*, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet DPBurgjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, t'i dërgohet përsëri kërkesë komisarjatis të policisë, ku të specifikohet lloji i veprës penale për të cilën është

² Drejtor i Përgjithshëm në detyrë në këtë periudhë ka qenë Z. Arben Çuko.

³ Drejtor i Përgjithshëm në detyrë në këtë periudhë ka qenë Z. Stefan Çipa.

dënuar V. M., rrezikshmërinë e trajtimit me leje në komunitet dhe monitorimin gjatë kohës së trajtimit me leje, si dhe informacion konfidencial që mund të disponohet për këtë të dënuar.

Email-i i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve drejtuar I EVP Fushë-Krujë në datën 21.11.2018 është dokumenti i fundit që ka të bëjë me kërkesën të dënuarit V. M. për të përfituar leje shpërblyese. Pra, evidentohet fakti se nuk është mbajtur një qëndrim përfundimtar institucional dhe t'i kthehet përgjigje të dënuarit për miratimin apo refuzimin e kërkesës.

Në përgjigjen që kemi marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën Nr.9828/3 Prot., datë 15.01.2021,⁴ jepet qëndrimi lidhur me kërkesën e paraqitur të të dënuarit në muajin Prill 2018, që në mënyrë të përmbledhur është si vijon:

“Raporti i sjellë nga I EVP-ja nuk ka të dhëna objektive për rrezikshmërinë e të dënuarit, por vetëm për respektimin e rregullores si dhe mungesën e masave disiplinore në fuqi. Leja shpërblyese është një e drejtë që e gëzojnë ata të dënuar që përmes një procesi vlerësimi në dinamikë kanë dhënë prova se janë të motivuar të shkëputen nga mendimet/besimet/sjelljet kriminale dhe se kanë ndërmarrë veprime konkrete drejt rehabilitimit dhe riintegritimit në shoqëri. Ndonëse i dënuari V. M. nuk ka patur masë disiplinore në periudhën kur ka paraqitur kërkesën për leje shpërblyese, ai në mënyrë të vazhdueshme ka mbajtur një qëndrim mohues ndaj veprës penale të kryer prej tij, duke dëshmuar kështu jo vetëm mungesë empatie dhe të fajit, por edhe mohim ndaj autoritetit, ligjit dhe gjykatave për dënimin që sipas tij është “i padrejtë”, ka patur nivele të ulëta të përfshirjes në veprimtari pro-sociale dhe të menaxhimit të zemërimit, ka shfaqur mungesë respekti ndaj atributëve dhe autoritetit të I EVP-së dhe stafit, ka demonstruar sjellje të qëllimshme për manipulimin e bashkëvuajtësve, përfshirë edhe elementë të natyrës dominante dhe kontrolluese ndaj tyre, pra në tërësi një individ me sjellje dhe qëndrime antisociale dhe pro kriminale. Gjithashtu, përgjigja e përcjellë nga Policia e Shtetit lidhur me rrezikshmërinë e të dënuarit në komunitet, nuk ka të dhëna të mjaftueshme sa lidhet me veprën penale për të cilën V. M. është dënuar, vepër penale që lidhet me terrorizmin. Verifikimi i komisarariatit të policisë është kryer për çështje nëse ka të dhëna që kthehet apo jo në burg apo nëse ka konflikte të mbartura. Ndërsa në fakt profili i tij kriminal ka lidhje me veprën penale për terrorizëm, elementë për të cilët konfirmimi i policisë së shtetit është inekzistent”.

Në përfundim të hetimit tonë administrativ⁵ konstatojmë se nuk është zbatuar procedura për shqyrtimin e kërkesës për leje shpërblyese për rastin e të dënuarit V. M. Konstatojmë se në praktikën që na është vënë në dispozicion mungon kërkesa fillestare e të dënuarit

⁴ Evidentohet se i kemi drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në mënyrë të përsëritur me kërkesë dhe kërkesë të përsëritur për informacion me shkresat: Nr. K2/V5-9 Prot., datë 17.10.2019, Nr. K2/V5-10 Prot., datë 21.01.2020, Nr. K2/V5-2 Prot., datë 29.09.2020, Nr. K2/V5-3 Prot., datë 17.11.2020 dhe Nr. K2/V5-4 Prot., datë 05.01.2021.

⁵ Vlen të theksojmë se, nuk ka qenë objekt i hetimit tonë administrativ, vlerësimi nëse ankuesit i takon apo jo të trajtohet me leje shpërblyese, **por vetëm nëse janë respektuar procedurat përkatëse, qoftë edhe në rast të refuzimit të kërkesës për leje.**

sipas formatit tip të Udhëzimit Nr.103, datë 14.02.2014 të Ministrit të Drejtësisë, raportet e sektorit të sigurisë, sektorit ligjor dhe sektorit të kujdesit social sipas formatit tip të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Drejtësisë. Po ashtu, mungon kthim përgjigje të dënuarit, ku ky i fundit duhet të informohet nëse është pranuar ose refuzuar kërkesa e tij, me argumentet përkatëse, mundësisë së ankimit si dhe afatet përkatëse.

Çmujmë se procedura e vlerësimit të kriterëve ligjore, që duhet të përmbushë i dënuari për të përfituar leje shpërblyese në rastin e të dënuarit V. M., ka zgjatur tej një afati të arsyeshëm duke patur parasysh edhe faktin që afati i shkurtër ligjor nuk është i mjaftueshëm për letërkëmbimin ndërmjet institucioneve dhe marrjen e informacionit në terren nga Policia e Shtetit⁶ si dhe duke mirëkuptuar pozitën e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të patur një siguri të shtuar lidhur me të dënuarit që shkojnë me leje shpërblyese. Procedura nuk është mbyllur me një vendimarrje duke e privuar të dënuarin nga mundësia për t'ju drejtuar gjykatës.⁷

Lidhur me kërkesën e paraqitur në vitin 2018, të dënuarit V. M. i është cënuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, më konkretisht në nenin 42/1 ku parashikohet se:

“Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor”;

dhe në nenin 4/2 të Kodit të Procedurës Administrative ku përcaktohet si vijon:

“Të drejtat apo interesat e ligjshme të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor”.

E drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter administrativ. Në këtë kuptim, çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë.

Po kështu, lënia për një kohë të gjatë e të dënuarit në pritje të një përgjigjeje, mospërfundimi i procedurës administrative me vënien në dijeni të kërkuesit lidhur me miratimin ose jo të lejes, nuk çon në krijimin e një raporti besimi me administratën e

⁶ Neni 59, paragrafi i pestë i Ligjit Nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, parashikon si vijon: “Brenda 7 ditëve nga marrja e kërkesës për leje, institucioni ku kryhet dënimi miraton lejen shpërblyese”.

⁷ Në nenin 59 të Ligjit Nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” parashikohet si më poshtë:

“ Në rast refuzimi të dhënies së lejes, i dënuari ose përfaqësuesi i tij ligjor ka të drejtë të bëjë ankim pranë Ministrit të Drejtësisë, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative brenda 5 ditëve dhe më pas ka të drejtë të ankohet në gjykatë, e cila vendos për kërkesën për leje”.

institucionit të ekzekutimeve penale që kërkesë/ankesat e të dënuarve trajtohen brenda një afati të përshtatshëm kohor. Fakti që ligji ka përcaktuar afate, tregon qëllimin e legjislatorit për të pasur qasje proaktive në këto raste.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut” si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave për respektimin e procedurës në të gjithë fazat e saj në përputhje me legjislacionin gjatë shqyrtimit të kërkesës së të dënuarit për të përfituar leje shpërblyese.
- Marrjen e masave përkatëse që procedurat të kryhen brenda afateve të përcaktuara ligjore.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi